

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje materiale pastrimi”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 39830000-9 - Detergjentë

VLERA E FONDIT LIMIT: 68 788 702,24 *(gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dy pikë njëzet e katër) Lekë pa Tvsh.*

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **734 765** *(shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro pa Tvsh.*

P.s Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 22.07.2026 është **93.62** *(nëntëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e dy).*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Sigurimi i ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë afatit të vlefshmërisë së saj, si dhe për të mbrojtur autoritetin kontraktor nga tërheqja e pajustificuar e ofertës, mosparaqitja e dokumentacionit provues ose refuzimi i nënshkrimit të kontratës nga ofertuesi fitues. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit kërkohet si mjet paraprak për verifikimin e përmbushjes së kushteve të kualifikimit, në funksion të zhvillimit të një procedure efikase, të shpejtë dhe të kontrollueshme. Këto kërkesa vlerësohen të nevojshme për garantimin e rregullshmërisë së procedurës së

prokurimit me objekt “Blerje materiale pastrimi”, të destinuara për përdorim në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. *(Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr.162/2020, si dhe në nenin 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i certifikatës ISO 9001 ose ekuivalente synon të provojë se operatori ekonomik ushtron veprimtarinë nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton standardizimin e proceseve, kontrollin e furnizimit dhe qëndrueshmërinë e cilësisë së produkteve. Duke qenë se objekt prokurimi janë materiale pastrimi që do të përdoren në objekte shkollore, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të sigurohet që furnizimi të realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat cilësore të përcaktuara. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën e kontratës dhe shërben për të verifikuar aftësinë organizative të operatorit ekonomik për ekzekutimin e rregullt të saj.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. *(Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79, pika 2, shkronja “c”, të Ligjit Nr.162/2020, si dhe në nenin 44 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i certifikatës ISO 14001 ose ekuivalente lidhet me natyrën e objektit të prokurimit, pasi materialet e pastrimit që do të përdoren në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës përfshijnë produkte që, për shkak të përbërjes dhe mënyrës së përdorimit të tyre, kërkojnë menaxhim të kontrolluar nga pikëpamja mjedisore. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit mjedisor për identifikimin, kontrollin dhe administrimin e ndikimeve që lidhen me aktivitetin e tij, përfshirë trajtimin, magazinimin dhe furnizimin e produkteve objekt kontrate. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën e kontratës dhe shërben për të garantuar që furnizimi të realizohet në përputhje me kërkesat teknike, funksionale dhe mjedisore që lidhen me përdorimin e këtyre produkteve në institucione arsimore.

Argumentimi: Këto kërkesa mbështeten në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79, pika 2, shkronja “c”, të Ligjit nr.162/2020, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Kërkesa

që organi i vlerësimit të konformitetit të jetë i akredituar synon të garantojë që certifikatat ISO të paraqitura nga operatori ekonomik janë lëshuar nga subjekte me njohje dhe besueshmëri institucionale, sipas standardeve të akreditimit të pranuar nga Republika e Shqipërisë. Paraqitja e certifikatës së akreditimit të organit lëshues është e nevojshme për të verifikuar vlefshmërinë, autenticitetin dhe forcën provuese të dokumentacionit të paraqitur në procedurë. Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për të kryer një vlerësim të mbështetur në prova të besueshme dhe të verifikueshme.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Paraqitja e pasqyrave financiare vjetore për 3 vitet e fundit kërkohet për t'i mundësuar autoritetit kontraktor verifikimin e gjendjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit ekonomik, në funksion të aftësisë së tij për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Nëpërmjet kësaj kërkesë synohet të vlerësohet nëse operatori ekonomik ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë me materiale pastrimi për objektet shkollorë të Bashkisë së Tiranës. Kushti që në dy balance të njëpasnjëshme të mos rezultojë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit është vendosur për të verifikuar një nivel minimal qëndrueshmërie financiare dhe për të shmangur rrezikun e mosrealizimit të kontratës për shkaqe që lidhen me paaftësinë ekonomike të operatorit. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i një xhiroje vjetore jo më të ulët se vlera e fondit limit synon të verifikojë se operatori ekonomik ka kapacitet financiar dhe aktivitet tregtar të mjaftueshëm për të përballuar realizimin e kontratës. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor vlerëson aftësinë e operatorit ekonomik për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë me materiale pastrimi për objektet shkollorë të Bashkisë së Tiranës. Kërkesa konsiderohet proporcionale, pasi përmbushja e xhiros minimale kërkohet vetëm në të paktën një vit të periudhës së përcaktuar, çka e bën kriterin të ekuilibruar dhe jo tej mase kufizues për konkurrencën, duke ruajtur njëkohësisht garancinë për qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i furnizimeve të ngjashme synon të verifikojë përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik në realizimin me sukses të kontratave të krahasueshme për nga natyra dhe vlera. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor vlerëson nëse operatori ekonomik ka kapacitetin teknik, organizativ dhe logjistik për të garantuar furnizim të rregullt dhe në kohë me materiale pastrimi për objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës. Përcaktimi i pragut në një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit, është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konsiderohet proporcional. Dokumentacioni i kërkuar shërben për verifikimin objektiv të natyrës, vlerës dhe realizimit me sukses të furnizimeve të mëparshme, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira, të paktën 2 (dy) automjete ATP (Automjet i Transportit të Përzier). Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit si: Lejen e Qarkullimit (*të vlefshme*), Siguracionin (*të vlefshëm*), Kolaudimin (*të vlefshëm*), Taksën e Qarkullimit (*të vlefshme*), ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit si: Lejen e Qarkullimit (*të vlefshme*), Siguracionin (*të vlefshëm*), Kolaudimin (*të vlefshëm*), Taksën e Qarkullimit (*të vlefshme*).

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur operatori ekonomik ofertues renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “ç”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Kërkesa për disponimin e të paktën dy

automjeteve ATP lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar transportin dhe shpërndarjen e rregullt, në kohë dhe në kushte të përshtatshme të materialeve të pastrimit në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë që operatori ekonomik ka kapacitetin minimal logjistik për realizimin e furnizimit sipas kërkesave të kontratës. Kriteri vlerësohet proporcional, pasi kërkon dy mjete transporti dhe lejon disponimin e tyre si në pronësi, ashtu edhe me qira, duke mos kufizuar në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Dokumentacioni i kërkuar shërben për të provuar disponueshmërinë reale dhe ligjshmërinë e përdorimit të automjetit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje/dokument që vërteton marrëdhënien midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit të autorizuar për qëllime verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 8, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është i nevojshëm për të garantuar origjinën e mallrave, ligjshmërinë e tregtimit të tyre dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për t'i siguruar ato sipas kërkesave të procedurës së prokurimit. Nëpërmjet këtij dokumentacioni, autoriteti kontraktor verifikon se operatori ekonomik ka një kanal furnizimi të rregullt, të gjurmueshëm dhe të autorizuar për produktet objekt prokurimi.

Ky kriter merr rëndësi të veçantë duke pasur parasysh natyrën dhe vëllimin e furnizimit me materiale pastrimi për objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës, pasi bëhet fjalë për sasi që kërkojnë kapacitete të qëndrueshme furnizimi dhe jo për produkte që mund të sigurohen në mënyrë të rastësishme në tregun e pakicës apo në marketet e zakonshme. Për vetë vëllimin, periodicitetin dhe nevojën për njëtrajtshmëri cilësore të produkteve, autoriteti kontraktor vlerëson se furnizimi duhet të mbështetet në burime të sigurta dhe të verifikueshme, në mënyrë që të shmanget rreziku i mungesës së mallrave, zëvendësimit të tyre me produkte të tjera ose mosrealizimit të kontratës sipas specifikimeve të kërkuara.

Kërkesa është proporcionale, pasi synon të provojë disponueshmërinë reale të produkteve dhe besueshmërinë e zinxhirit të furnizimit, pa vendosur kufizime të panevojshme. Në rastet kur autorizimi paraqitet nga distributori, kërkesa për paraqitjen e dokumentit që provon marrëdhënien ndërmjet tij dhe prodhuesit është e nevojshme për të garantuar gjurmueshmërinë dhe vlefshmërinë e autorizimit. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor sigurohet se operatori ekonomik është realisht në gjendje të furnizojë produktet e kërkuara, në sasinë, cilësinë dhe afatet e përcaktuara.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike për mallrat objekt prokurimi (përveç produkteve detergjentë dhe solucione me numrat rendor Nr. 1, 2, 9, 23, 24). Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit

prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021. Paraqitja e katalogëve, fragmenteve të katalogëve ose skedave teknike kërkohet me qëllim verifikimin objektiv dhe të drejtpërdrejtë të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëpërmjet këtij dokumentacioni, autoriteti kontraktor krijon mundësinë të vlerësojë nëse produktet e ofruara përmbushin karakteristikat teknike të kërkuara, pa u mbështetur vetëm në deklarime të përgjithshme të operatorit ekonomik. Ky kriter merr rëndësi të veçantë duke pasur parasysh natyrën e kontratës, pasi materialet e pastrimit që do të përdoren në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës duhet të jenë të përshtatshme për përdorim institucional, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit teknik shërben për të garantuar transparencën, saktësinë dhe krahasueshmërinë e vlerësimit të ofertave, si dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Për rrjedhojë, kriteri vlerësohet proporcional me objektin e prokurimit dhe i nevojshëm për të provuar përputhshmërinë teknike të mallrave të ofruara.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi detergjentë dhe solucione me Nr. 1, 2, 9, 23, 24, sipas Shtojcës 7, duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it, si dhe fletë analizat të lëshuara nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, për përqendrimin e lëndëve tensioaktive.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenet 77 dhe 79 të Ligjit Nr.162/2020, në nenin 40, pika 6, shkronja “c”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, si dhe në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e kimikateve dhe detergjentëve, përfshirë Ligjin nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” dhe VKM nr.9, datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Kërkimi i dokumentit me të dhënat e sigurisë (MSDS), të lëshuar ose publikuar nga prodhuesi, si dhe i fletë-analizave të lëshuara nga laboratorë të akredituar për përqendrimin e lëndëve tensioaktive, është i nevojshëm për të verifikuar në mënyrë objektive përbërjen, karakteristikat e sigurisë dhe përputhshmërinë teknike të detergjentëve dhe solucioneve objekt prokurimi. Nëpërmjet MSDS-së, autoriteti kontraktor sigurohet që disponon informacion të plotë dhe të standardizuar mbi klasifikimin e rrezikut, masat e mbrojtjes, kushtet e magazinimit, transportit, përdorimit dhe masat që duhen marrë në rast incidenti, ndërsa nëpërmjet fletë-analizave laboratorike verifikohet përmbushja e parametrave teknikë që lidhen drejtpërdrejt me përbërjen dhe efikasitetin e produkteve, përfshirë përqendrimin e lëndëve tensioaktive sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Duke qenë se këto produkte do të përdoren në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës, autoriteti kontraktor vlerëson se përputhshmëria e tyre nuk mund të mbështetet vetëm në deklarime tregtare apo përshkrime të përgjithshme të operatorit ekonomik, por duhet të provohet me dokumentacion teknik dhe të sigurisë, të verifikueshëm dhe të besueshëm. Ky kriter

është proporcional me natyrën e produkteve dhe i nevojshëm për të garantuar furnizimin me produkte të përshtatshme për përdorim institucional, në përputhje me kërkesat teknike, funksionale, higjieno-sanitare dhe të sigurisë.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi me Nr. 1, 2, 9, 13, 17, 23, 24, 25 - duhet të paraqesë mostrat (kampionet) në ditën e hapjes së ofertave, për artikujt e kërkuar. Mostrat e paraqitura duhet të kenë të ngjitur një etiketë, në të cilën të shënohen: “Mostër – emri i artikullit”, data e zhvillimit të tenderit, emri i ofertuesit, si dhe nënshkrimi dhe vula e operatorit ekonomik. Gjithashtu, mostrat duhet të jenë të njëjta me produktet që janë paraqitur nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në Sistemin e Publikimeve Elektronike (SPE).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.488, datë 29.06.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.669 datë 28.09.2011, “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet”. Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se për artikujt e përcaktuar paraqitja e mostrave është e nevojshme, pasi për disa karakteristika të rëndësishme të produktit verifikimi dokumentar nuk është gjithmonë i mjaftueshëm. Nëpërmjet mostrave bëhet i mundur verifikimi fizik i elementeve të tillë si paraqitja, ambalazhimi, etiketimi, konfeksioni, identifikimi i produktit dhe përputhshmëria e tij me dokumentacionin teknik të paraqitur në SPE. Kjo i jep autoritetit kontraktor mundësinë të krijojë bindje të plotë mbi faktin se produkti i ofruar nuk ekziston vetëm në përshkrim, por është realisht i disponueshëm dhe i identifikueshëm sipas kërkesave të procedurës. Kërkesa për etiketimin e mostrave është vendosur për arsye administrimi, gjurmueshmërie dhe sigurie procedurale, me qëllim shmangien e konfuzionit gjatë procesit të vlerësimit dhe lidhjen e saktë të secilës mostër me ofertuesin dhe artikullin përkatës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë, si pjesë të dokumentacionit të ofertës, dokumentin me emërtimin “Ofertë Teknike”, për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Ky dokument duhet të hartohet në përputhje me listën e artikujve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7, duke pasqyruar për secilin produkt të dhënat teknike dhe identifikuese të nevojshme.

“Oferta Teknike” duhet të plotësohet në mënyrë të plotë, të saktë dhe të qartë për të gjithë artikujt e kërkuar, sipas renditjes së parashikuar në listën/preventivin e Autoritetit Kontraktor, dhe duhet të përmbajë minimalisht këto të dhëna:

Nr.	Emërtimi i produktit	Emërtimi i subjektit prodhues	Emërtimi i katalogut/skedës teknike	Kodi i produktit ose numri i faqes në katalog/skedë teknike	Shënime Nëse ofertuesi e vlerëson të nevojshme për sqarime shtesë
-----	----------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---	--

Për plotësimin e këtij kriteri duhet të respektohen kërkesat e mëposhtme:

- ❖ Emërtimi dhe renditja e produkteve në dokumentin “Ofertë Teknike” duhet të jetë në përputhje me listën e artikujve/preventivin e paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7.
- ❖ Për çdo produkt të ofruar, ofertuesi duhet të përcaktojë katalogun, skedën teknike të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar, si dhe referencën përkatëse ku gjenden të dhënat teknike të produktit. Referenca duhet të jetë e qartë dhe e verifikueshme, duke përfshirë kodin e produktit ose, në mungesë të tij, numrin e faqes në katalog/skedë teknike, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund të identifikojë dhe verifikojë përputhshmërinë e specifikimeve teknike të produktit të ofruar me specifikimet e kërkuara në dokumentet e tenderit.
- ❖ Në rubrikën “Shënime”, operatori ekonomik ofertues mund të paraqesë sqarime plotësuese lidhur me produktet e ofruara, nëse i vlerëson të nevojshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe të nenit 44 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter ka si qëllim të mundësojë identifikimin e qartë, të saktë dhe të verifikueshëm të mallrave të ofruara nga operatorët ekonomikë, në raport me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit. Paraqitja e dokumentit “Ofertë Teknike”, e plotësuar për çdo artikull sipas renditjes dhe emërimit të listës së paraqitur në Shtojcën 7, krijon mundësinë që komisioni i vlerësimit të ofertave të krahasojë në mënyrë objektive të dhënat teknike të produkteve të ofruara me kërkesat e DST-së.

Kërkesa për përcaktimin e prodhuesit, katalogut ose skedës teknike, kodit të produktit apo numrit të faqes përkatëse në katalog, është e nevojshme për të shmangur paqartësitë gjatë procesit të vlerësimit, veçanërisht në rastet kur prodhues apo distributorë të ndryshëm paraqesin produkte me emërtime, pamje ose karakteristika të ngjashme. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor ka mundësi të verifikojë drejtpërdrejt burimin teknik të informacionit dhe përputhshmërinë e produktit të ofruar me specifikimet e kërkuara.

Ky kriter nuk synon të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por të garantojë transparencë, saktësi dhe gjurmueshmëri në dokumentacionin teknik të paraqitur, duke ndihmuar në një vlerësim të drejtë, të barabartë dhe të bazuar në dokumente të verifikueshme. Gjithashtu, ai i shërben shmangies së konfuzionit, gabimeve të interpretimit dhe ofertimit të produkteve të papërcaktuara qartë, duke mbrojtur interesin e Autoritetit Kontraktor për të siguruar mallra që përmbushin plotësisht kërkesat teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i ngritur me urdhër të Titullarit, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, dhe nenin 36, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin

40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, VKM nr.220, datë 28.03.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”, VKM nr.669, datë 28.09.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet”, Ligjin nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo-ushqimore”, si dhe nenin 9 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”.

Specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të autoritetit kontraktor dhe në funksion të përdorimit të produkteve në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës. Qëllimi i tyre është të garantojnë furnizimin me produkte të përshtatshme për përdorim institucional, që përmbushin kërkesat e nevojshme të cilësisë, sigurisë, efikasitetit dhe përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Për secilin artikull janë përcaktuar karakteristika teknike që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e produktit, mënyrën e përdorimit, përbërjen, funksionalitetin, parametrat fiziko-kimikë dhe kërkesat e sigurisë, me qëllim sigurimin e produkteve të përshtatshme për ambiente shkollore me përdorim të përditshëm dhe frekuentim të lartë.

Parametrat teknikë janë hartuar gjithashtu duke marrë në konsideratë formatet e paketimit dhe konfeksionet që gjenden realisht në treg, me qëllim garantimin e funksionalitetit të furnizimit, shpërndarjes, magazinimit dhe përdorimit të produkteve. Përshkrimi teknik është bërë në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme për të shmangur paqartësitë gjatë ofertimit dhe vlerësimit, si dhe për të mundësuar krahasimin objektiv të ofertave. Për tregues të veçantë, si pH, lagështia, tretshmëria, densiteti dhe përqendrimi i lëndëve tensioaktive, përcaktimi në dokumentet e tenderit është bërë për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë që këta parametra kanë në cilësinë, stabilitetin, sigurinë dhe efikasitetin e produkteve detergjente dhe të pastrimit. Në këto kushte, specifikimet teknike vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me objektin e prokurimit, nuk krijojnë kufizime të pajustificuara për konkurrencën dhe i shërbejnë drejtpërdrejt garantimit të furnizimit me produkte të sigurt, funksionale dhe të përshtatshme për përdorim në objektet shkollore të Bashkisë së Tiranës.

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit Znj. Xhesika Lajmeri, Specialiste fushe me detyrë Përgjegjëse në Sektorin e Mirëmbajtjes së Pajisjeve Elektroshtëpiake.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Blerje materiale pastrimi”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim, Znj. Marisa Kaçori, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.